

**PROCESET HISTORIKE DHE POLITIKE DERI TEK PAVARËSIA E  
KOSOVËS, 1999-2008**

**TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I HISTORISË**

**NGA:**

**ARLIND HAJDARI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË**

**PRISHTINË  
QERSHOR, 2022**

## **EKSPOZE E TEMËS**

### **PROCESET HISTORIKE DHE POLITIKE DERI TEK PAVARËSIA E KOSOVËS, 1999-2008**

**Mentor:**

**Prof. Asoc. Selim Bezeraj**

**Kandidati:**

**Arlind Hajdari**

Të shkruash për historinë e re të Kosovës dhe për ngjarjet që karakterizojnë historinë e popullit shqiptar të Kosovës nga çlirimi e deri tek Pavarësia e Kosovës, përveçse është sakrificë është edhe krenari për të trajtuar një temë të një rëndësie kaq të madhe. Historia e Kosovës e fundvitit 1999 është e karakterizuar me përpjekjet e një populli që kërkonte çlirim e liri, një populli që sulmohej ushtarakisht vazhdimisht nga agresori që po kërkonte territore të Kosovës, një armik siç ishte shteti serb. Prandaj, vitet 98-99 përbëjnë vitet e përpjekjeve të plota të kohës së luftës për çlirim e paqe e mbi të gjitha vitet kur filloi vërtetë rezistenca ushtarake në mbrojtje të territoreve e në mbrojtje të popullatës vendase nga ushtria vendase, pra nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës që luftonte drejtpërsëdrejti me agresorin serb. Pavarësisht fuqisë jo të madhe ushtarake që kishte UÇK-ja në rezistencën e këtyre viteve vullneti ishte i fuqishëm për të mbrojtur vendin e tyre që populli shqiptar i Kosovës nuk kërkonte asgjë tjetër përveçse çlirim nga armiku që nuk po lejonte të ushtronte të drejtat e tyre universale dhe po sulmonte popullsinë vendase nga dita në ditë me sulme të ndryshme.

Prandaj, falë përgaditjes në mbrojtje, përpjekjeve e rezistencës së fuqishme, luftës së armatosur e bashkëpunimin që kishte me aleatët ndërkombëtar, më 24 mars 1999 Kosova po merrte drejtim të ri. Moment vendimtar në historinë e Kosovës që duhet mbajtur gjatë në kokë ishin sulmet e NATO-s, sulme që kishin qëllim kryesor ndalimin e dhunës që po ushtrohej ndaj popullatës vendase dhe ndaljen e gjenocidit në pranverën e vitit 1999. Këto sulme të kordinuara nga Bashkësia ndërkombëtare me luftëtarët e UCK-së dhe me komandantët e zonave operative sollën çlirimin e Kosovës në qershor të vitit 1999. Kur momenti i çlirimit të vendit nga okupatori ndodhi, në Kosovë erdhi një administrator paqeje. Ky administrator i ri që po bënte menaxhimin e gjendjes në Kosovë

ishite një mission ndërkombëtar që kishte qëllim kryesor rregullimin e gjendjes në Kosovën e pasluftës, një vendi që kishte shkatërrime të mëdha në fusha të ndryshme duke përfshirë shkatërrimet nga më të ndryshmet si ato: ekonomike, kulturore, administrative, sociale e politike. Sfidat e vendit ishin të mëdha e puna kërkonte përgaditje për të rregulluar gjendjen e vendit e për të përgaditur Kosovën për proceset e ardhshme politike drejt zgjidhjes së statutit. Vitet e pasluftës ishin vitet që përbëjnë administrimin ndërkombëtar, pra vitet e udheheqjes së misionit të UNMIK-ut.

Misioni i vendosur në Kosovë po rregullonte gjendjen e brendshme të vendit për ta dërguar Kosovën në hapat e ardhshëm final për zgjidhjen e statutit final. Pas përfundimit të statutit Kosova po shkonte drejt hapave të një shteti të ri, shtet që po kërkonte të drejtat e tij që nga shekulli XX kur u nda padrejtësisht nga shteti fqinj amë. Kosova po shkonte drejt zgjidhjes së statutit, atëherë sfidë e radhës ishin Negociatat e Vjenës që përbënte një takim negociues mes pales kosovare dhe asaj serbe në ndërmjetësim nga të huajt që po përpiqeshin të zgjidhnin problemin e luftës dhe të paçes në mënyrë që të dyja të pranonin marrëveshjen që do të mundësonte që Kosova të shpallej shtet. Vitet 2007-2008 përbëjnë vitet e fazës finale të negociatave ndërsa 17 shkurti i vitit 2008 përbën datën sublime me ç'rast Kosova u shpall shtet i pavarur dhe demokratik.

Kjo rrugë deri tek Pavarësia përmban procese me rendësi të madhe politike dhe historike me domethenie të madhe e mbi të gjitha sfida e përpjekje, por megjithatë vullneti e sakrificat për shtet ishin të mëdha. Ëndrra u bë realitet për qytetarët dhe të gjithë dëshmorët e Kosovës që sakrifkuan sepse Kosova u çlirua nga armiku shekullor Serbia dhe u bë shtet më 17 shkurt 2008. Por vendimi më zyrtar që kurorëzoi të gjitha përpjekjet e sakrificat ishte vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili në mënyrë zyrtare e bën të qartë se Kosova më 17 shkurt 2008 nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare.